



Më
Dana

31 - 03 - 2010



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO GJYKATA
KOMUNALE NË FERIZAJ/ OPŠTINSKI SUD U UROŠEVCU/ MUNICIPAL COURT IN FERIZAJ

P.nr.293/2008

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ, gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Agim Maliqi dhe sekretaren juridike Florije Jakupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED], për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 1 nënpar.4 të KPK-ës, sipas propozim akuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj, PP. nr. 379/2008 të datës 17.04.2008, në shqyrtimin e hapur gjyqësor të mbajtur me 18 shkurt 2010 në praninë e Prokurorit publik Agron Çalaj, të akuzuarit dhe të dëmtuarit [REDACTED] mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i lindur me [REDACTED] në Ferizaj, me vendbanim në Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] i martuar babë i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së varfër ekonomike, deri me tani e pa dënuar,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datën 20 shkurt 2007 rreth orës 14,15 në vendqëndrimin për taksi, te udhëkryqi i rr."Rexhep Bislimi" me rr."Ahmet Kaçiku" në Ferizaj, i ka shkaktuar lëndim trupor të dëmtuarit [REDACTED] në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishte pasur vëllai i tij [REDACTED] me të dëmtuarin, të cilët punojnë si taksistë, i pandehuri e sulmon fizikisht duke e goditur me grusht në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, plagë shtypëse të qafës, plagë gërvishtëse të hundës, plagë shtypëse të mollëzës të faqes së majtë dhe plagë shtypëse e kofshës së këmbës së djathtë, të përshkruara në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë,

Me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nen. 153 par. 1 nënpar. 4 të KPK-ës.

Gjykata në kuptim të nen. 153 par. 1 nënpar.4 dhe nen. 3, 6, 11, 15, 34, 41, 42, 43, 44 dhe 64 të KPK-ës, dhe nenit 391 të KPPK-ës, e

G J Y K O N

DËNIM ME KUSHT

I VËRTETOHET dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tre/ muajve, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një viti nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 /pesëdhjetë/ Euro, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 25,55 /njëzet e pesë euro e pesëdhjetë e pesë centi/ Euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcimin e ekzekutimit me dhunë.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

A r s y e t i m i

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor shpalli aktgjykimin në prezencën e prokurorit publik, të akuzuarit dhe të dëmtuarit përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit dhe paushallin gjyqësor.

Pas shpalljes së aktgjykimit palët konform nenit 394 par. 1 të KPPK-ës janë udhëzuar mbi të drejtën në ankesë dhe për detyrimin për ta paralajmëruar ankesën.

Pas kësaj Prokurori publik, i akuzuari dhe i dëmtuari deklaruan se nuk paralajmërojnë ankesë përkatësisht heqin dorë nga e drejta e ankesës kundër aktgjykimit të shpallur.

Gjykata në kuptim të nenit 400 par. 3 të KPPK-ës, konstatoi meqë palët me të drejtë ankese nuk paralajmëruan ankesë, nuk është e nevojshme që aktgjykimi i përpiluar me shkrim të përfshijë arsyetimin.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ, me 18.02.2010,
P.nr.293/2008.

Se kretarja juridike,
F.Jakupi

Gjyqtari individual,
Agim MADIQI

